



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Doretuar Puniljeno/Prodato Received/Delivery	02. 02 2024	viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKNMSHCK	668/2024		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1532/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1532/2023 të datës 18.12.2023 e parashtruar nga ankuesi me adresë

kundër Vendimit KD.nr.062/2023 të datës 16.11.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridiko-administrative "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi, 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.02.2024 mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1532/2023 e datës 18.12.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Anullohet Vendimi KD.nr.062/2023 i datës 16.11.2023 i Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi, _____ i cili sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës, me datë 11.12.2023 ka parashtruar ankesë përmes poste në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është pranuar me datë 18.12.2023 dhe

është protokolluar me numër:7530/2023 nën shenjën A.nr.1532/2023, kundër Vendimit KD.nr.062/2023 të datës 16.11.2023 i Komisionit Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes vendimit përmes të cilit ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore ka vepruar dhe ka konstatuar gabimisht gjendjen faktike, pasi që i njëjti nuk ka qenë në orar pune gjatë ndërrimit të natës ndërmjet datave 11/12 tetor 2023, po ashtu pozita e punës është "Mbikëqyrës i Lartë" dhe jo "Mbikëqyrës i Lartë për Siguri" sikurse Komisioni Disiplinor ka pretenduar dhe po ashtu i njëjti lidhur me qasjen në kamera apo kthimin prapa të video incizimeve e bënë vetëm sipas kërkesës së drejtorit të Qendrës së paraburgimit në Gjilan, me arsyetimin se Komisioni Disiplinor nuk ka marrë për bazë gjatë seancës së mbajtur asnjë nga argumentet apo qëndrimet e paraqitura duke zbatuar kështu gabimisht dispozitat e ligjit material, me kërkesën që Këshilli të aprovojë ankesën e ankuesit si të bazuar ndërsa të anulojë Vendimi e datës 16.11.2023 me numër KD.nr.062/2023 të Komisionit Disiplinor.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.12.2013 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli më datë 11.01.2024 ka pranuar nga Shërbimi Korrektues të Kosovës përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Sipas kërkesës së datës 29.01.2024, Kryetari i Këshillit ma datë 31.01.2024 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2024 përmes të cilit ankesës së ankuesit me shifër A.nr.1532/2024 të datës 18.12.2023 ia ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, administroi këto prova: Ankesën me Nr.prot:5730/2023 të datës 18.12.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me numër KD.nr.062/2023 i datës 16.11.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Kontrata e punës për kohë të pacaktuar; Përshkrimi i përgjithshëm i punës i datës 31.07.2019; Inicimi i procedurës disiplinore i datës 20.10.2023; Ftesën për interviste të datës 23.10.2023; Formularin për regjistrimin e stafit korrektuese të datës 11.10.2023; Prania në vendin e punës e datës 11.10.2023; Formularin për regjistrimin e stafit korrektuese të datës 12.10.2023; Prania në vendin e punës e datës 12.10.2023; Formularin për regjistrimin e stafit korrektuese të datës 13.10.2023; Fletë kthesën me numër KD.nr.062/23; Vendimin e datës 23.12.2019; Vendimin e datës 28.01.2020; Vendimin e datës 11.11.2023; Procesverbalin e datës 25.10.2023; E-malin e datës 13.10.2023 nga për ; E-malin e datës 27.09.2023 nga për ; E-malin e datës 07.10.2023 nga për ; E-malin e datës 16.10.2023 nga për Formulari për kontrollimin e vendeve të punës e datës 14.10.2023; E-malin e datës 14.10.2023 nga për Plani i punës për Mbikëqyrje të Institucioneve Korrektuese i datës 18.10.2023; E-mailin e datës 25.01.2024 dërguar nga Këshilli për Autorizimin e datës 02.12.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi është punësuar sipas Kontratës së Punës të datës 06.09.2018 (për kohë të pacaktuar) është i punësuar në pozitën e

punës "Mbikëqyrës i Lartë", në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ndërsa sipas Autorizimit të datës 02.12.2022 të lëshuar nga Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan i njëjti është autorizuar në detyra shtesë të punës "Mbikëqyrjen dhe kontrollin e kamerave në Qendrës së Paraburgimit në Gjilan".

Ekipi për mbikëqyrjen e Institucioneve Korrektuese sipas planit të punës, me datë 13.10.2023 kanë vizatuar Qendrën e Paraburgimit në Gjilan dhe më datë 18.10.2023 ka përgatitur planin e punës për mbikëqyrjen e Institucioneve Korrektuese, ku tek fusha e Menaxhimit të Burgosurve me Probleme të Shëndetit Mendor, është konstatuar se janë shikuar video incizimet e sistemit CCTV ku nga pamjet e kamerave datë 12.10.2023 nga ora 23:55 është vërtetuar se zyrtarët korrektues nuk kanë vepruar sipas obligimeve dhe përgjegjësit që kanë sipas detyrës zyrtare me ç'rast ndaj të burgosurve dhe nuk është bërë mbikëqyrja e shtuar nga zyrtarët të cilët kanë qenë në detyrë në pavijonet përkatëse ku kanë qenë të vendosur këta të burgosur konkretisht krahu P-2, krahu L-3 dhe Krahu L-5, për rrjedhojë mbi bazë të këtij raporti më datë 20.10.2023 Komisionit Disiplinor sipas detyrës zyrtare nga raporti i pranuar, ndaj ankuesit dhe zyrtarëve të tjerë ka iniciuar procedurë disiplinore me pretendimet për shkelje disiplinore.

Komisioni Disiplinor pas zhvillimit të procedurës disiplinore dhe mbajtjes së seancës së shqyrtimit verbal, me datë 16.11.2023 ka nxjerr Vendimit KD.nr.062/2023 përmes të cilit ankuesit ka shqiptuar masën disiplinore "ndalim i 20% të pagës për periudhën prej një (1) muaji", me arsyetimin se ankuesi ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës të përcaktuara me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik nga nenin 56 paragrafi 4 nën paragrafin 4.1, 4.2 dhe 4.4 ku përcaktohet se: "4.Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhencë e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale" ndërlidhur me nenin 58 paragrafi 3 në paragrafi 3.4 dhe 3.12 të Ligjit Nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës ku përcaktohet se: "Shkelje të rënda disiplinore për personelin e SHKK-së konsiderohen: 3.4. shkeljet serioze e rregullave të sigurisë; 3.12. mosveprimi në pajtim me ligjin, aktet nënligjore dhe rregullat e brendshme të punës" pasi që lidhur me rastin e konstatuar nga Ekipa për mbikëqyrjen e Institucioneve Korrektuese sipas raportit të datë 18.10.2023, Komisioni Disiplinor ka ardhur në përfundimin se ankuesi ka dështuar të zbatoj obligimet që rrjedhën sipas detyrave funksionale të punës ngase si mbikëqyrës i kamerave të sigurisë nuk ka arritur t'i vëzhgojë zyrtarët korrektues lidhur me lëshimet e bëra sipas rastit të evidentuar.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë dhe pranueshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ka analizuar përkrahimin e detyrave të punës të ofruara në cilësi të provave materiale nga institucioni punëdhënës përmes shkresës së datës 11.01.2024 dhe ka gjetur se përkrahimi i detyrave të punës për pozitën Mbikëqyrës i Lartë është si vijon : "Mbikëqyrë dhe udhëheqë personelin korrektues vartës së tij; Si anëtar i ekipit udhëheqës, të jetë i pranishëm në mbledhje, t'i informojë udhëheqësit për zhvillimin e punëve; Kryen detyra kyçe në mungesë të Udhëheqësit të Sigurisë pas orarit të rregullt të punës dhe gjatë fundjavave; Është pjesë e ekipit për zgjidhjen e situatave të ndërlikuara për personelin korrektues dhe të burgosurve; Rregullisht viziton të gjitha zonat dhe hapësirat e burgut dhe për çdo parregullsi raporton tek Udhëheqësi i Sigurisë; Të përshtat planin për pushim vjetor, orarin, disiplinën për staf dhe monitoroj pushimet mjekësore të stafit; Të bëjë planin e evakuimit emergjent; Të jap propozime për ndryshimin e rutinës për të paraburgosurit /dënuarit; Në baza ditore shqyrton kërkesat, ankesat dhe pakënaqësitë eventuale të paraburgosurve dhe personelit, duke regjistruar dhe dokumentuar ato; Në rastin e incidenteve të ndryshme, sigurohet që të kompletohen të gjitha shkresat e nevojshme për dokumentimin e incidentit; Të zbatojë detyrat siç janë

kërkuar nga Udhëheqësi i Sigurisë dhe të raportojë tek Udhëheqësi i Sigurisë me gojë dhe me shkrim për të gjitha çështjet operative dhe të sigurisë”, ndërsa lidhur me orarin zyrtar të punës Kolegji i Këshillit iu referuar Formularit të regjistrimit apo vijueshmërisë në punës dhe gjeti se me datë 11.10.2023 ankuesi është lajmëruar në punë në orën 07:35 të mëngjesit ndërsa ka dal nga puna në ora 16:20, sipas Formularit të regjistrimit apo vijueshmërisë në punës gjeti se me datë 12.10.2023 ankuesi është lajmëruar në punë në orën 08:00 të mëngjesit ndërsa ka dal nga puna në ora 16:20; sipas Formularit të regjistrimit apo vijueshmërisë në punës gjeti se me datë 13.10.2023 ankuesi është lajmëruar në punë në orën 08:00 të mëngjesit ndërsa ka dal nga puna në ora 17:00, po ashtu sipas Raportit 12 orësh të ndërrimit të natës dhe atë nga 19:00-07:00 për datat 10/11.10.2023 vërtetohet se në ndërrimin e natës ka qenë Mbikëqyrësi i Lartë sipas Raportit 12 orësh të ndërrimit të natës dhe atë nga 19:00-07:00 për datat 11/12.10.2023 vërtetohet se në ndërrimin e natës ka qenë Mbikëqyrësi i Lartë sipas Raportit 12 orësh të ndërrimit të natës dhe atë nga 19:00-07:00 për datat 11/12.10.2023 vërtetohet se në ndërrimin e natës ka qenë Mbikëqyrësi i Lartë ; sipas Raportit 12 orësh të ndërrimit të natës dhe atë nga 19:00-07:00 për datat 12/13.10.2023 vërtetohet se në ndërrimin e natës ka qenë Mbikëqyrësi i Lartë , kurse sipas e-mailit të datës 13.10.2023 dhe atë datës 19.10.2023 dërguar nga Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan për ankuesin, evidentohet faktike si kthimi i kamerave apo i incizimeve nga kamerat bëhet vetëm sipas kërkesës së Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit.

Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës të ofruara nga palët në këtë çështje administrative dhe shqyrtimi veç e veç i tyre dhe të gjithave së bashku si tërësi, arriti në përfundimin se Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës së rëndë disiplinore për shkelje të rënda disiplinore ndaj ankuesit, ka konstatuar gabimisht gjendjen faktike e për rrjedhojë ka zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit material dhe atij të posaçëm, ngase në rrethanat e rastet konkret ndërlidhur me të gjeturat e raportit të datës 18.12.2023 nga Ekipa për mbikëqyrjen e Institucioneve Korrektuese sipas vizitës së bërë të datës 13.12.2023, nuk mund t'i lihen apo atribuohen në përgjegjësi ankuesit nga ana e Komisionit Disiplinor, ngase i njëjti në datat respektive me 11 dhe 12 tetor 2023 nuk ka qenë në ndërrimin e natës, respektivisht sipas formularëve të stafit në detyrë, ankuesi për datat 11-12 dhe 13 tetor 2023 ka pasur orar të rregullt punë dhe atë nga ora 08:00 deri në ora 16:00, prandaj lidhur me lëshimet eventuale nga zyrtarë të tjerë të përcaktuar në detyrë jashtë këtij orari zyrtar në të cilën ankuesi ka qenë i përcaktuar, nuk mund të bien mbi barrën e përgjegjësisë së tij, sikurse konstatohet fakti se sipas Autorizimit të datës 02.12.2022 të lëshuar nga Drejtori i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan i njëjti është autorizuar në detyra shtesë të punës “Mbikëqyrjen dhe kontrollin e kamerave në Qendrës së Paraburgimit në Gjilan” e ku në pikën III të të njëjtit autorizim përcaktohet në mënyrë të qartë se: “Ky autorizim i dhënë nuk krijon asnjë të drejtë apo detyrim tjetër shtesë sipas kontratës së punës apo të drejtave dhe detyrimeve të punës dhe dispozitave ligjore në fuqi” dhe duke shtuar faktin se sipas shkresave të lëndës ankuesi i kthen kamerat për verifikimin e situatave apo rasteve vetëm sipas kërkesës së Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit, e që sipas përcaktimit të këtij autorizimi ngjarjet e filmuara apo incizuara e të cilat mund të jenë shkelje nga zyrtarët në detyrë gjatë asaj kohe kur ankuesi nuk është sipas detyrës zyrtare në punë, nuk mund të cilësohen si shkelje disiplinore nga ankuesi, ngase ky autorizim ka përcaktuar qartë se nuk krijon detyrime shtese përtej kontratës së punës apo përshkrimit të detyrave funksionale të punës.

Prandaj, Kolegji i Këshillit pas konstatimit të saktë të gjendjes faktike dhe analizimit të rrethanave të rastit konkret mbi provat e administruara të lëndës dhe duke u mbështetur në

dispozitat e nenit 86 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"1. Organi publik detyrohet, sipas detyrës zyrtare, të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative. 3. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, dokumentet që vërtetojnë akte, fakte, cilësi apo gjendje subjektive, të nevojshme për shqyrtimin administrativ, administrohen, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që zhvillon procedurën administrative, nëse janë në administrim të tij apo të organeve të tjera publike. Organi publik mund t'i kërkojë palës vetëm informatat e nevojshme për identifikimin e tyre."* arriti në përfundimin se Komisioni Disiplinor për shkak të lëshimeve dhe mos zbatimit të drejtë të dispozitave të lartcekura ligjore nuk ka arritur të konstatoi drejtë gjendjen faktike, sikurse nuk ka arritur të shqyrtojë të gjitha faktet dhe të vlerësojë të gjitha rrethanat e nevojshme për zgjidhjen e çështjes administrative të cilat ankuesi me të drejtë i ka ngritur, gjegjësisht Komisioni Disiplinor gjendjen e dhënë faktike nuk e ka mbështetur në prova konkrete, pavarësisht se sipas detyrës zyrtarë ka mundur të ketë çasje të pakufizuar në të gjitha shkresat e lëndës apo rastit konkrete, sikurse të njëjtat shkresa apo akte që konstatojnë gjendjen e ndryshme faktike nga ajo e dhënë në arsyetimin e aktit të kontestuar kanë qenë të disponueshme brenda të të njëjtit organizmin institucional/Shërbimit Korrektues të Kosovës, andaj duke marrë për bazë dispozitat e nenit 47 dhe 48 ndërlidhur me nenin 52 paragrafi 1 në paragrafi 1.3, 1.4 dhe 1.5 të të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *"Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material"* Kolegji i Këshillit konstaton se Vendimit KD.nr.062/2023 i datës 16.11.2023 i Komisionit Disiplinor është akt administrativ i paligjshëm dhe si i tillë është anuluar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi ndërsa pretendimet ankimore ankuesit dhe ankesa e tij e datës 18.12.2023 është plotësisht e bazuar dhe ka mbështetje ligjore ngase nga provat e lëndës është arritur deri tek një konstatim i tillë.

Andaj duke marrë për bazë arsyetimin e dhënë si më lartë dhe në mbështetje të dispozitave të nenit 130 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ndërlidhur me nenin 143 paragrafi 1 në paragrafi 1.1 dhe 1.2, ashtu që nëse akti i goditur është bërë i ekzekutueshëm, institucioni punëdhënës, gjegjësisht Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme administrative që të bëjë kompensimin e diferencës në pagë të ankuesit, si dhe masën disiplinore ta largoi nga dosje personale e ankuesit, ngase parashtrimi i ankesës së ankuesit në Këshill sipas fuqisë së ligjit krijon efekte pezulluese ndaj aktit të goditur, ashtu që i njëjti ndaj palës që i drejtohet nuk mund të krijoj apo prodhojë efekte juridike deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar që zgjedhë ankesën e tij.

Theksuar si me lart, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1532/2023

Flakron GASHI

Flakron Gashi
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Eshref SHABANI

Eshref Shabani
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

